



Komuna e Vitisë  
Municipality of Viti  
Opstina Vitina



MJESIESIA FAMILJARE  
PORODICNA MEDICINA  
FAMILY MEDICINE  
QKMF-2

No. 08 D. 14.01.2026

VITI - VITINA



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti  
Main Family Health Center  
Glavni Centar Porodici Medicine

## QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE NË VITI

### Plani i punës për vitin 2026

Drejtoreshë e QKMF-së në Viti  
Dr. Vjollca Kadolli Halili

Date: 14.01.2026

Komuna e Vitisë ka një popullsi prej 35566 banorë sipas regjistrimit të ASK të vitit 2024. Përpos për Komunën e Vitisë ne ofrojmë shërbime shëndetësore edhe për komunën e Klllokoit.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti (QKMF) ka për synim identifikimin e nevojave të qytetarëve të Komunës së Vitisë dhe ofrimin sa më efikas të shërbimeve shëndetësore. QKMF në Viti funksionin e vet e ushtron duke u bazuar në:

1. Ligji për Shëndetësi 04/L-125
2. Udhëzimin Administrativ 04/2020 për KPSH
3. Statutin e QKMF-së në Viti
4. Ligjin e Punës nr.03/L-212
5. Ligjin për Zyrtarët Publik nr.08/L-197

Prioritetet e QKMF-së në Viti janë:

- Promovimi i shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve,
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit të QKMF-së,
- Planin për investime kapitale
- Zhvillimi i programeve për promovimin e shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve ndërmjet fushatave vetëdijësuese dhe masave preventive.
- Përfshirja e Komunitetit -Inkurajimi i përfshirjes aktive të komunitetit në hartimin dhe implementimin e programeve shëndetësore dhe sociale.
- Trajnimin e stafit shëndetësore,
- Aktivitete të ndryshme në komunitet në bashkëpunim me Këshillin e Pacientëve
- Bashkëpunimi me institucionet e tjera me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimeve.
- Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit ( Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshem për monitorim dhe vlerësim të shërbimeve shëndetësore për të përmirësuar shërbimet, në bashkëpunim me institucione tjera).

## Plani i aktiviteteve për vitin 2026

Plani i punës së QKMF-së në Viti për vitin 2026 përfshinë një sërë aktiviteteve që lidhen me planifikimin dhe realizimin e objektivave të parapara për vitin 2026. Bashkë me Këshillin Drejtues të QKMF-së në Viti kemi përcaktuar objektivat kryesore për vitin 2026, të cilat do të ndikojnë në rritjen e kualitetit të shërbimeve shëndetësore në të gjitha njësitë e saj. Këtë vit ne presim rezultate të kënaqshme në pikëpamje të angazhimit të punëtorëve (mjek, infermier dhe personel tjetër si në QKMF ashtu në QMF dhe AMF në teren) në procesin e punës, përmirësimit të disiplinës në punë dhe organizimit me të mirë dhe efikas të punës në të gjitha njësitë.

QMF dhe AMF në teren) në procesin e punës, përmirësimit të disiplinës në punë dhe organizimit me të mirë dhe efikas të punës në të gjitha njësitë.

QKMF në Viti është i vetmi institucion shëndetësor publik që përkujdeset për shëndetin e afër 36000 banorëve të Komunës së Vitisë, QKMF ofron shërbime parësore shëndetësore për popullatën të Komunës, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Republikës së Kosovës.

Kujdesi Parësor Shëndetësor për qytetarët e Komunës e Vitisë është i organizuar nëpërmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Viti, katër (4) Qendra të Mjekësisë Familjare - QMF dhe 7 (shtatë) Ambulanta të Mjekësisë Familjare- AMF:

1. QMF-Pozheran
2. QMF-Sillatinë e Epërme
3. QMF-Smirë
4. QMF-Sadovinë e Jerlive
5. AMF-Beguncë
6. AMF-Skifteraj
7. AMF-Stubëll
8. AMF-Tërpezë
9. AMF-Letnicë
10. AMF-Remnik
11. AMF-Goshicë

Me këtë plan vjetor parashihen objektivat e planifikuara, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në QKMF, QMF dhe AMF, organizimi dhe udhëheqja, burimet njerëzore dhe plani financiar për këtë vit.

Veprimtaria e QKMF, QMF dhe AMF është që të bëjë ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor të popullatës së komunës sonë, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror nëpërmes të zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare.

Më poshtë janë të paraqitura të gjitha aktivitetet në formë tabelare:

|   | Objektivat e planifikuara                                                              | Rezultatet e pritshme                                                                                  |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1 | Përmirësimi i menaxhimit dhe mbikqyrjes së punës së QKMF-së dhe njësitë vartëse të saj | <i>Rritja e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore.</i>                   |
| 2 | Funksionalizimi dhe avancimi i shërbimeve financiare dhe administrative                | <i>Menaxhim i drejtë, racional dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i>                         |
| 3 | Trajnimet e stafit shëndetësorë                                                        | Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit shëndetësor                                            |
| 4 | Sigurimi i furnizimit të rregullt dhe të mjaftueshëm me barra dhe material shpenzues   | Furnizim i rregullt sipas nevojave                                                                     |
| 5 | Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Zyrës së Cilësisë                                  | <i>Monitorim, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të shërbimeve shëndetësore.</i> |
| 6 | Hartimi dhe zbatimi i Planit Vjetor për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional            | <i>Hartimi i planit të ZHVP –së në përputhje me politikat shëndetësore dhe prioritetet e QKMF-së.</i>  |
| 7 | Blerja dhe Mirëmbajtja e aparaturave mjekësore                                         | <i>Furnizimi me aparatura të reja për të gjitha njësitë</i>                                            |

| Objektivat e planifikuara |                                                                    |            |                                                                     |                                                                    |                   |
|---------------------------|--------------------------------------------------------------------|------------|---------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|-------------------|
| Objek<br>tivi             |                                                                    | Aktiviteti | Objektivi                                                           | Aktivitetet e realizuara                                           | Indikato<br>matës |
| I                         | Menaxhimi efikas i mbarëvajtjes së punës në QKMF dhe njësitë e saj | 1.1        | Mbajja e takimeve mujore të menaxhmentit me përgjegjësit e njërive. | Takime mujore menaxheriale                                         | 12 takim<br>vit   |
|                           |                                                                    | 1.2        | Takimet e rregullta të Këshillit profesional                        | Raportim mujor/vjetor                                              | 12 takim<br>vit   |
|                           |                                                                    | 1.3        | Rishqyrtimi kolegjial                                               | Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve shëndetësore                | 6 takime          |
|                           |                                                                    | 1.4        | Auditet Klinike                                                     | Vlerësimi i shërbimeve të ofruara në QKMF                          | 3 takime          |
|                           |                                                                    | 1.5        | Raportimi i rregullt i përgjegjësve të njërive                      | Raportimi i rregullt mujor për punët në QKMF                       | 12 takim<br>vit   |
|                           |                                                                    | 1.6        | Plani i punës së Zyrtarës/Kordinatorit të Cilësisë                  | Objektivat e caktuara të punës së zyrtarit/kordinatorit të QKMF-së | janar             |

|     |                                 |     |                                                          |                                                                                             |                        |
|-----|---------------------------------|-----|----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
|     |                                 | 2.2 | Menaxhimi i prokurimit sipas planit vjetor               | Numri i procedurave të prokurimit të përfunduara sipas planit.                              | Janar                  |
|     |                                 | 2.3 | Evidenca administrative të stafit.                       | Përditësimi i evidencave administrative të stafit.                                          | vazhdimi               |
|     |                                 | 2.4 | Trajnime për stafin administrativ në menaxhim financiar. | Numri i trajnimeve administrative të realizuar                                              | 1 trajnim              |
|     |                                 | 2.5 | Plani detaj për shpalljen e tenderëve të planifikuar     | Realizimin me kohë në të gjitha investimet e planifikuara në QKMF                           | mentor                 |
|     |                                 | 2.6 | Inkasimi i mjeteve nga bashkëpagesat                     | Rritja e inkasimit të mjeteve nga të hyrat vetanake (zbatimi i çmimoreve të bashkëpagesave) | mujore                 |
|     |                                 | 2.7 | Plani për pushimet vjetore                               | Shfrytëzueshmëria e pushimeve vjetore sipas ligjit të punës                                 | janar                  |
|     |                                 | 2.8 | Evidentimi i dokumenteve në baze të protokollit          | Protokolli i me kohë të gjitha dokumenteve zyrtare                                          |                        |
| III | Trajnimet e stafit shëndetësorë | 3.1 | Plani i punës së ZHVP-së                                 | Zbatimi i planit të punës së ZHVP-së në përpikmëri                                          | Janar                  |
|     |                                 | 3.2 | Identifikimi i nevojave për trajnim                      | Numri i trajnimeve të realizuara gjatë vitit.                                               | 12 trajnim vit         |
|     |                                 | 3.3 | Organizimi i trajnimeve profesionale dhe punëtorive      | Përqindja e stafit të trajnuar (≥70%).                                                      |                        |
|     |                                 | 3.4 | Mbështetja e pjesëmarrjes në trajnime të akredituara     | Numri i krediteve të fituara për ZHVP.                                                      | 20 kredi në vit/puntor |
|     |                                 | 3.5 | Monitorimi i pjesëmarrjes dhe vlerësimi pas trajnimeve   | Raporte vlerësimi pas trajnimeve                                                            | 12 në vit              |

|    |                                           |     |                                                                                                  |                                                                                                  |             |
|----|-------------------------------------------|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|    |                                           | 3.6 | Shënimi I ditëve botërore të shëndetësisë sipas Kalendarit të Promocionit të Shëndetit           | Edukimi dhe promovimi shëndetësorë në komunitet në kordinim me Keshillin e Pacientëve            | 8 ne vit    |
|    |                                           | 3.7 | Trajnimi I stafit per PAK                                                                        | Përgaditja e stafit për ofrimin e shërbimit shëndetësorë për PAK                                 | 1 trajnim   |
| IV | Furnizimi me barna dhe material shpenzues | 4.1 | Plani i furnizimit me barna dhe material hargjues sipas listes esenciale dhe kontratave komunale | Furnizimi i rregullt dhe me kohë me barna dhe material shpenzues për të gjitha njesite e QKMF-se | janar       |
|    |                                           | 4.2 | Planifikimi vjetor i nevojave për barna dhe materiale.                                           | Përqindja e furnizimit sipas planit (≥90%).                                                      | janar       |
|    |                                           | 4.3 | Monitorimi i stokut dhe afateve të skadencës.                                                    | Reduktimi i barnave të skaduara.                                                                 | 1 here ne i |
|    |                                           | 4.4 | Raportim mujor për mungesa eventuale.                                                            | Numri i rasteve të mungesës së barnave esenciale.                                                | vazhdimës   |
|    |                                           | 4.5 | Koordinim me DSHMS dhe furnitorët.                                                               | Raporte mujore të stokut të realizuara.                                                          | 2 here ne i |
|    |                                           | 4.6 | Planifikimi vjetor i nevojave për barna dhe materiale.                                           | Përqindja e furnizimit sipas planit (≥90%).                                                      | dhjetor     |
| V  | Aktivitetet e Zyrës së Cilësisë           | 5.1 | Zbatimi i aktiviteteve të Zyrës së Cilësisë                                                      | Monitorim, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të shërbimeve shëndetësore.  |             |
|    |                                           | 5.2 | Monitorimi i respektimit të protokolleve klinike.                                                | Numri i auditimeve të cilësisë të realizuara.                                                    | 3 ne vit    |
|    |                                           | 5.3 | Auditime të brendshme të cilësisë.                                                               | Përqindja e rekomandimeve të zbatuara                                                            | vazhdimës   |
|    |                                           | 5.4 | Menaxhimi i ankesave dhe sugjerimeve të pacientëve.                                              | Numri i ankesave të trajtuara brenda afatit..                                                    | vazhdimës   |
|    |                                           | 5.5 | Zbatimi i masave përmirësuese.                                                                   | Raporte periodike të cilësisë.                                                                   | 4 në vit    |

| VI  | Planit Vjetor për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional (ZVHP) | 6.1 | Zbatimi i Planit Vjetor për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional (ZVHP) | Hartimi i planit të ZHP –së në përputhje me politikat shëndetësore dhe prioritetet e QKMF-së.                                 |         |
|-----|--------------------------------------------------------------|-----|------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|
|     |                                                              |     |                                                                        |                                                                                                                               |         |
|     |                                                              |     |                                                                        |                                                                                                                               |         |
|     |                                                              |     |                                                                        |                                                                                                                               |         |
|     |                                                              |     |                                                                        |                                                                                                                               |         |
|     |                                                              |     |                                                                        |                                                                                                                               |         |
|     |                                                              | 6.2 | Hartimi dhe miratimi i Planit Vjetor të ZHP-së                         | Plani i ZVHP i miratuar në fillim të vitit.                                                                                   | janar   |
|     |                                                              | 6.3 | Organizimi i trajnimeve të brendshme dhe të jashtme.                   | Numri i aktiviteteve të ZVHP të realizuara.                                                                                   | 12      |
|     |                                                              | 6.4 | Evidentimi i krediteve profesionale.                                   | Përqindja e stafit që ka përmbyshur kreditë e nevojshme.                                                                      | 90%     |
|     |                                                              | 6.5 | Raportim vjetor për ZHP                                                | Raporti vjetor i ZHP i dorëzuar.                                                                                              | dhjetor |
|     |                                                              | 6.6 | Hartimi dhe miratimi i Planit Vjetor të ZVHP.                          | Plani i ZVHP i miratuar në fillim të vitit.                                                                                   | dhjetor |
| VII | Blerja dhe Mirëmbajtja e aparaturave mjekësore               | 7.1 | Furnizimi me aparaturë të reja për të gjitha njësitë                   | 1. Blerje e aparaturave të reja mjekësore, bazuar në kërkesat e njësisve<br>2. Rritje e kualitetit të shërbimeve shëndetësore |         |
|     |                                                              | 7.2 | Mirëmbajtja dhe servisi i aparaturave aktuale                          | Pajisje të servisuara me kohë dhe të mirëmbajtura                                                                             | Tetor   |